



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
*Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 28.02.2019

Dokument parlamentar

**RAPORT**  
**PËR PROJEKTLIGJIN**  
**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES,**  
**NDËRMJET PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNITIT POLICOR PËR**  
**EVROPËN JUGLINDORE, PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË**  
**DHËNAVE TË ADN-SË, DAKTILOSKOPIKE DHE TË TË DHËNAVE TË**  
**REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE, DHE MARRËVESHJES SË SAJ ZBATUESE”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të konventës së bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”, në mbledhjen e datës 28 shkurt 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Rakip Suli relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Me anë të këtij projektligji synohet forcimi i bashkëpunimit policor ndërkufitar, ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimet e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

Marrëveshja që ratifikohet përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Me anën e shkëmbimit automatik të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, Shqipërisë i krijohet mundësia që të shfrytëzojë bazat e të dhënave të shteteve të tjera që do të bëhen palë të marrëveshjes, duke i dhënë akses që të kontrollojë profilet e ADN-së, shenjat daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve, si të shtetasve shqiptarë ashtu dhe profilet e ADN-së të ngjarjeve kriminale të ndodhura në Shqipëri, me qëllim identifikimin on-line të personave që janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal apo kanë ndryshuar të dhënat e tyre identifikuese, emër, mbiemër etj.

- ***Diskutimi në komision***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi këtë projektligj, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 28 shkurt 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t'u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së Brendshme.

Në përgjigje të pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e ministrisë së Brendshme sqaruan se marrëveshja ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshja e saj zbatuese, është nënshkruar në Vjenë, në 13 shtator 2018, nga Palët: Republika e Shqipërisë, Republika e Austrisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Hungaria, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Rumania, Republika e Serbisë, Republika e Sllovenisë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit policor ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimet e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

Ky projektligj përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Me anën e shkëmbimit automatik të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, Shqipërisë i krijohet mundësia që të shfrytëzojë 10 bazat e të dhënave të shteteve të tjera që do të bëhen palë të projektligjit, duke i dhënë akses që të kontrollojë profilet e ADN-së, shenjat daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve, si të shtetasve shqiptarë ashtu dhe profilet e ADN-së të ngjarjeve kriminale të

ndodhura në Shqipëri, me qëllim identifikimin *on-line* të personave që janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal apo kanë ndryshuar të dhënat e tyre identifikuese, emër, mbiemër etj.

**Në përfundim të diskutimeve**, Komisioni, me shumicë votash, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

**RELATOR**

**KRYETAR**

**Rakip SULI**

**Niko PELESHI**